

# TRASHËGIMIA KULTURORE NË

# FO KU S.

TRASHËGIMIA KULTURORE NË SHqipëri

TRASHËGIMIA  
KULTURORE NË  
FO  
KU  
S.



BOTIMI I TEKSTEVE BURIMORE  
MBI PRAKTIKAT E RUAJTJES DHE  
MENAXHIMIT TË TRASHËGIMISË  
KULTURORE NË GJUHËN SHQIPE

**Titulli:** “Trashëgimia Kulturore në Fokus: Botimi i teksteve burimore mbi praktikat e ruajtjes dhe menaxhimit të trashëgimisë kulturore në gjuhën shqipe”

Botimi është mundësuar nga “Trashëgimia Kulturore pa Kufij Shqipëri” (Cultural Heritage without Borders Albania (CHwB Albania) me mbështetjen financiare të Suedisë nëpërmjet Agjencisë Ndërkombëtare për Zhvillim.

**Përkthimet nga origjinali:** Të ndryshëm referuar në çdo dokument përkatësisht

**Redaktoi:** Boiken Abazi

**Parathënie për botimin nga:** Elena Mamani, Lorenc Bejko dhe Boiken Abazi

**Koordinoi procesin e përkthimeve dhe publikimit:**

Elena Mamani, Regina Vathi, Pezana Rexha

**Foto:** © Bjori Thana, Regina Vathi

**Dizajni:** Ina (Hina) Shkëmbi, Joniz Osmanagaj

© CHwB Albania © ICOMOS Albania

Viti i botimit: 2023

196 f.: me foto ; 21 x 21 cm

**ISBN: 9789928801081**

1.Pasuria kulturore 2.Ruajtja dhe restaurimi 3.Menaxhimi 4.Shqipëri

904 :72 .03(496.5)

**Shtëpia Botuese:** “Graphic Line-01”



This work is distributed under the Creative Commons BY-NC-ND 4.0 licence, which enables re-users to copy and distribute the material in any medium or format in non-adapted form only, for non-commercial purposes only, and only so long as attribution is given to the creator.

Ky botim publikohet bazuar në licencën nga “Creative Commons BY-NC-ND 4.0”, e cila u mundëson ripërdoruesve të kopjojnë dhe shpërndajnë materialin në çdo mënyrë komunikimi ose format, por vetëm duke mos kryer përshtatje të formës, duke mos e përdorur për qëllime tregtare, si dhe për aq kohë sa i jepet krijuesit atributi përkatës.

# KARTA E BURRËS

Karta e Australia ICOMOS Inc. për vendet me rëndësi kulturore.

## AUSTRALIA ICOMOS Inc.

Përkthyer nga: Lorenc Bejko.

Redaktuar nga: Boiken Abazi.

Versioni origjinal © Australia ICOMOS Incorporated 2013.

Ky përkthim nuk është përkthim zyrtar ICOMOS-it në Australi. Ky përkthim në gjuhën shqipe botohet me lejen e ICOMOS-it në Australi, por nën përgjegjësinë e vetme të përkthyesit/botuesit.

## ICOMOS-I NË AUSTRALI

### Këshilli Ndërkombëtar për Monumentet dhe Sitet

ICOMOS-i (Këshilli Ndërkombëtar për Monumentet dhe Sitet) është një organizatë profesionale jo-qeveritare e formuar në vitin 1965, me seli në Paris. ICOMOS-i është kryesisht i interesuar për filozofinë, terminologjinë, metodologjinë dhe teknikat e konservimit të trashëgimisë kulturore. Ai është i lidhur ngushtë me UNESCO-n, si këshilluesi kryesor i UNESCO-s për çështjet kulturore të Trashëgimisë Botërore, veçanërisht në rolin e tij sipas Konventës së Trashëgimisë Botërore, të vitit 1972. 11,000 anëtarët e ICOMOS-it përfshijnë arkitektë, urbanistë, demografë, arkeologë, gjeografë, historianë, konservues, antropologë, shkencëtarë, inxhinierë dhe administratorë të trashëgimisë. Anëtarët e ICOMOS-it nga 103 vende, organizohen në Komitetet Kombëtare përkatëse dhe marrin pjesë në një varg projektesh konservimi, në punë kërkimore, në shkëmbime ndërkulturore dhe në aktivitete bashkëpunimi. ICOMOS-i gjithashtu ka 27 Komitete Shkencore Ndërkombëtare që përqëndrohen në aspekte të veçanta të fushës së konservimit. Anëtarët e ICOMOS-it mbledhen çdo tre vjet në një Asamble të Përgjithshme.

## ICOMOS-I NË AUSTRALI

Komiteti Kombëtar Australian i ICOMOS-it (ICOMOS-i në Australi) u themelua në vitin 1976. Ai zgjedh një Komitet Ekzekutiv prej 15 anëtarësh, që është përgjegjës për realizimin e programeve kombëtare dhe për të marrë pjesë në vendimet e ICOMOS-it si një organizatë ndërkombëtare. Ai ofron këshilla të specializuara sipas kërkesave të ICOMOS-it, veçanërisht në lidhje me marrëdhëniet e tij me Komitetin e Trashëgimisë Botërore. ICOMOS-i në Australi vepron si një pikëlidhje kombëtare dhe ndërkombëtare ndërmjet autoriteteve publike, institucioneve dhe individëve të përfshirë në studimin dhe konservimin e të gjitha vendeve me domethënie (rëndësi) kulturore. Anëtarët e ICOMOS-it në Australi marrin pjesë në një sërë aktiviteteve konservuese duke përfshirë vizitat në terren, trajnimet, konferencat dhe takimet.

## RISHIKIMI I KARTËS SË BURRËS

Karta e Burrës u miratua për herë të parë në vitin 1979 në Burra – qytet historik i minierave në Australinë Jugore. Rishikime të vogla i janë bërë në vitet 1981 dhe 1988, dhe ndryshime më thelbësore janë kryer në vitin 1999. Pas një rishikimi, ky version u miratua nga ICOMOS-i në

Australi, në tetor të vitit 2013. Procesi i shqyrtimit përfshiu zëvendësimin e Udhëzimeve të Kartës së Burrës të vitit 1988 bashkë me Shënimet Praktike, të cilat gjenden në adresën: [australia.icomos.org](http://australia.icomos.org).

Dokumentet e ICOMOS-it në Australi rishikohen periodikisht dhe ne mirëpresim çdo koment.

## CITIMI I KARTËS SË BURRËS

Referenca e plotë është Karta e Burrës: Karta e ICOMOS-it në Australi për vendet me rëndësi kulturore, 2013. Referencat fillestare në tekst duhen bërë duke shënuar si në vijm: Karta e Burrës nga ICOMOS-i në Australi, 2013. Referenca të mëtejshme mund t'i bëhen në formën e shkurtuar: Karta e Burrës.

© Australia ICOMOS Incorporated 2013

Karta e Burrës përbëhet nga Parathënia, Nenet, Shënimet shpjeguese dhe Grafiku i rrjedhës së procesit. Ky botim mund të riprodhohet vetëm në formën e tij të plotë, duke përfshirë kopertinën e përparme dhe këtë faqe. Formatimi duhet të mbetet i pandryshuar. Pjesë të Kartës së Burrës mund të citohen duke përdorur referencat dhe shënimet e përshtatshme përkatëse.

Fotografia e kopertinës (së botimit origjinal) nga Ian Stapleton.

Australia ICOMOS Incorporated [ARBN 155 731 025]  
Sekretariati: c/o Fakulteti i Arteve  
Universiteti Deakin  
Burwood, VIC 3125  
Australi  
<http://australia.icomos.org/>

ISBN 0 9578528 4 3

Duke marrë parasysh Kartën Ndërkombëtare për Konservimin dhe Restaurimin e Monumenteve dhe Siteve (Venecia, 1964), dhe Rezolutat e Asamblesë së 5-të të Përgjithshme të Këshillit Ndërkombëtar për Monumentet dhe Site (ICOMOS) (Moskë, 1978), Karta e Burrës u miratua nga ICOMOS-i në Australi (Komiteti Kombëtar Australian i ICOMOS-it) më 19 gusht 1979 në Burra, në Australinë Jugore. Rishikimet u miratuan më 23 shkurt 1981, 23 prill 1988, 26 nëntor 1999 dhe më 31 tetor 2013.

Karta e Burrës ofron udhëzime për ruajtjen dhe menaxhimin (administrimin) e vendeve me rëndësi kulturore (site me domethënie të trashëgimisë kulturore) dhe bazohet mbi njohuritë dhe përvojën e anëtarëve të ICOMOS-it në Australi.

Konservimi është një pjesë përbërëse e menaxhimit të vendeve me rëndësi (domethënie) kulturore dhe është një përgjegjësi e vazhdueshme.

#### ***Për kë është Karta?***

Karta përcakton një praktikë standarde për ata të cilët japin këshilla, marrin vendime ose ndërmarrin punime në vende me rëndësi (domethënie) kulturore, duke përfshirë pronarët, menaxherët (administratorët) dhe kujdestarët.

#### ***Përdorimi i Kartës***

Karta duhet lexuar në tërësi. Shumë nene janë të ndërvarur nga njeri-tjetri.

Karta përbëhet nga:

- Përkufizime Neni 1
- Parimet e konservimit Nenet 2-13
- Proceset e konservimit Nenet 14-25
- Praktikën konservuese Nenet 26-34
- Grafiku i rrjedhës së procesit të Kartës së Burrës.

Konceptet kryesore janë përfshirë në pjesën *Parimet e konservimit* dhe janë zhvilluar më tej në pjesët *Proceset e konservimit* dhe *Praktikën konservuese*. Grafiku i rrjedhës së procesit shpjegon procesin e Kartës së Burrës (Neni 6) dhe është pjesë përbërëse e Kartës. Shënime shpjeguese janë gjithashtu pjesë përbërëse e Kartës.

Karta është një dokument i vetëmjaftueshëm, por aspekte të përdorimit dhe zbatimit të saj shpjegohen më tej në një seri Shënimesh Praktike të ICOMOS-it në Australi, në Kartën e Burrës me ilustrime, dhe në dokumente të tjera

udhëzuese që gjenden në faqen e internetit të ICOMOS-it në Australi: [australia.icomos.org](http://australia.icomos.org).

#### ***Për cilat vende zbatohet Karta?***

Karta mund të zbatohet në të gjitha llojet e vendeve me rëndësi (domethënie) kulturore, duke përfshirë ato natyrore, indigjene dhe vendet historike me vlera kulturore. Standardet e organizatave të tjera mund të jenë gjithashtu të vlefshme. Këto përfshijnë *Kartën e Trashëgimisë Natyrore Australiane*, *Pyet fillimisht: një udhëzues për respektimin e siteve dhe vlerave të trashëgimisë indigjene dhe Domethënia 2.0: një udhëzues për vlerësimin e domethënies së koleksioneve*. Kartat kombëtare dhe ndërkombëtare dhe doktrina të tjera mund të jenë gjithashtu të rëndësishme. Shih [australia.icomos.org](http://australia.icomos.org).

#### ***Pse konservohet?***

Vendet me rëndësi kulturore pasurojnë jetën e njerëzve, shpesh duke ofruar një ndjenjë të thellë dhe frymëzuese të lidhjes me komunitetin dhe peizazhin, me të kaluarën dhe me përvojat e jetuara. Ato janë dokumente historike, që janë shprehje e rëndësishme e identitetit dhe përvojës australiane. Vendet me domethënie kulturore pasqyrojnë larminë e komuniteteve tona, duke na treguar se kush jemi, si dhe të kaluarën që na ka formuar ne dhe peizazhin australian. Ato janë të pazëvendësueshme dhe të vyeshme. Këto vende me rëndësi kulturore duhet të konservohen për brezat e sotëm dhe të ardhshëm, në përputhje me parimin e barazisë ndër-brezo. Karta e Burrës promovon një qasje të kujdeshme ndaj ndryshimit: bëni aq sa është e nevojshme për t'u kujdesur për vendin dhe për ta bërë atë të përdorshëm, por përtej kësaj, ndryshojeni atë sa më pak të jetë e mundur, në mënyrë që të ruhet domethënia e tij kulturore.

**Neni 1. Përkufizimet**

Për qëllimet e kësaj Karte:

- |   |  |
|---|--|
| <p>1.1 <i>Vend</i> nënkupton një zonë të përcaktuar gjeografikisht. Mund të përfshijë elemente, objekte, hapësira dhe pamje. Vendi mund të ketë dimensione të prekshme dhe të paprekshme.</p>   | <p>Vendi ka një kuptim të gjerë dhe përfshin elemente natyrore dhe kulturore. Vendi mund të jetë i madh ose i vogël: për shembull, një përmendore, një pemë, një ndërtesë individuale ose grup ndërtesash, mund të jetë vendn- dodhja e një ngjarjeje historike, një zonë urbane ose qytet/qytezë, një peizazh kulturor, një kopsht, një ndërtesë industriale, një anije e mbytur, një vend me rrënoja "in situ", një strukturë gurësh, një rrugë ose një itinerar, një vend takimi për komunitetin, një sit me lidhje shpirtërore ose fetare.</p> |
| <p>1.2 <i>Domethënia (rëndësia) kulturore</i> nënkupton vlera estetike, historike, shkencore, sociale ose shpirtërore për brezat e kaluar, të sotëm apo të ardhshëm.</p> <p>Domethënia kulturore mishërohet në vetë <i>vendin, strukturën dhe mjedisin rrethues, përdorimin, asociacionet, kuptimet</i>, të dhënat, <i>vendet dhe objektet e ndërlidhura me të.</i></p> <p>Vendet mund të kenë një sërë vlerash për individë ose grupe të ndryshëm.</p> | <p>Togfjalëshi "domethënie (rëndësi) kulturore" është sinonim me "domethënie të trashëgimisë kulturore" dhe me "vlera të trashëgimisë kulturore".</p> <p>Domethënia kulturore mund të ndryshojë me kalimin e kohës dhe nga përdorimi.</p> <p>Kuptimi i domethënies kulturore mund të ndryshojë nga një informacion i ri.</p>   |
| <p>1.3 <i>Struktura</i> nënkupton të gjithë materialin fizik të vendit, duke përfshirë elemente, instalime, përmbajtje dhe objekte.</p>   | <p>Struktura përfshin ambientet e brendshme të ndërtesave dhe mbetjet nëntokësore, si dhe materialet e gërmuara. Elementet natyrore të një vendi mundet gjithashtu të jenë pjesë e strukturës. Për shembull, shkëmbinjtë që përfaqësojnë një "Dreaming place" (vend ëndërimi). Struktura mund të përcaktojë hapësira dhe pamje, dhe këto mund të jenë pjesë e domethënies së vendit.</p>   |
| <p>1.4 <i>Konservimi</i> nënkupton të gjitha proceset e përkujdesjes për një vend, në mënyrë që ai të ruajë <i>domethënien (rëndësinë) e tij kulturore.</i></p>   | <p>Shih gjithashtu Nenin 14.</p>   |
| <p>1.5 <i>Mirëmbajtja</i> nënkupton kujdesin e vazhdueshëm ndaj një vendi dhe <i>mjedisit të tij rrethues.</i></p> <p>Mirëmbajtja duhet dalluar nga riparimi, që përfshin <i>restaurimin ose rindërtimin.</i></p>   | <p>Shembuj të kujdesit mbrojtës përfshijnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• mirëmbajtje - inspektim i rregullt dhe pastrimi i një vendi, p.sh. kositje dhe krasitje në një kopsht;</li> <li>• riparim me natyrë restauruese - kthimi i strukturës së shpërbërë ose të zhvendosur në vendndodhjen e saj origjinale, p.sh. ulluqet e rëna të çatisë së një ndërtese, ose blloqet e zhvendosur të një unazë</li> </ul>   |

guri e njohur si “bora ring” (shënim nga përkthyesi: “bora ring” përdoret nga popujt indigjenë të Australisë për funksione rituale);

- riparimi me natyrë rindërtuese – zëvendësimi i strukturës së prishur me një strukturë të re.

1.6 *Ruajtja* nënkupton mbajtjen e një vendi në gjendjen ekzistuese dhe vonimin në kohë të përkeqësimit.

Është e ditur se të gjitha vendet dhe elementët e tyre ndryshojnë me kalimin e kohës me ritme të ndryshme.

1.7 *Restaurimi* nënkupton kthimin e një vendi në një gjendje të mëhershme që njihet, duke hequr shtesat ose duke ribashkuar elementet ekzistues pa futjen e materialit të ri.

1.8 *Rindërtimi* nënkupton kthimin e një vendi në një gjendje të mëhershme që njihet, dhe dallon nga *restaurimi* për nga futja e materialeve të reja.

Materiali i ri mund të përfshijë materiale të ricikluara që kanë shpëtuar pa u prishur në vende të tjera. Kjo nuk duhet kryer në dëm të ndonjë vendi tjetër me domethënie kulturore.

1.9 *Përshtatje* nënkupton ndryshimin e një vendi në funksion të përdorimit ekzistues ose të një përdorimi të propozuar.

1.10 *Përdorimi* nënkupton funksionet e një vendi, duke përfshirë aktivitetet dhe praktikat tradicionale dhe zakonore që mund të mbahen te ai vend, ose që janë të varura nga ai vend.

Për shembull, përdorimi përfshin praktikat kulturore të lidhura zakon- isht me popujt indigjenë, si ceremonitë, gjuetia dhe peshkimi, si dhe përmbushja e detyrimeve tradicionale. Përdorim mund të konsiderohet edhe ushtrimi i të drejtës së qasjes.

1.11 *Përdorimi i përshtatshëm* nënkupton një përdorim që respekton *domethënien kulturore të një vendi*. Një përdorim i tillë përjashton çdo ndikim, ose ka një ndikim minimal mbi domethënien kulturore.

1.12 *Mjedisi rrethues* nënkupton ambientin/ kontekstin e atypëratyshëm dhe të zgjeruar të një vendi, dhe që është pjesë e domethënies kulturore dhe karakterit dallues të vendit, ose kontribuon në të.

Mjedisi rrethues mund të përfshijë: struktura, hapësira, tokë, ujë dhe qiell; kontekstin pamor, duke përfshirë fushëpamjet drej vendit dhe nga vendi, si dhe përgjatë një itinerari kulturor; dhe aspekte të tjera shqisore të mjedisit rrethues, si erërat që nuhaten dhe tingujt që dëgjoohen.

1.13 *Vend i ndërlidhur* nënkupton një vend që kontribuon në domethënien kulturore të një vendi tjetër.

1.14 *Objekti i ndërlidhur* nënkupton një objekt që kontribuon në domethënien kulturore të një vendi, por nuk ndodhet në atë vend.

Objektet në një vend përfshihen përmes përkufizimit të vendit, dhe mundet të kontribuojnë ose jo në domethënien e tij kulturore.

1.15 Asociacionet (bashkëshoqërimet) nënkuptojnë lidhjet që ekzistojnë ndërmjet njerëzve dhe një vendi.

Asociacionet (bashkëshoqërimet) mund të përfshijnë vlera shoqërore ose shpirtërore, si dhe përgjegjësi kulturore për një vend.

1.16 *Kuptimet* tregojnë domethënien e një vendi, si dhe atë çka u paraqet, ndjell ose shpreh njerëzve.

Në përgjithësi, kuptimet lidhen me dimensionet e paprekshme, siç janë cilësitë simbolike dhe kujtimet.

1.17 *Interpretimi* nënkupton të gjitha mënyrat e paraqitjes (prezantimit) së *domethënies kulturore* të një vendi.

Interpretimi mund të jetë një kombinim i trajtimit të strukturës (p.sh. mirëmbajtja, restaurimi, rindërtimi); përdorimi i vendit dhe aktivitetet në të; si dhe përdorimi i materialeve shpjeguese.

## PARIMET E KONSERVIMIT

### Neni 2. Ruajtja dhe menaxhimi (administrimi)

- 2.1 *Vendet me domethënie kulturore* duhet të konservohen.
- 2.2 Qëllimi i *konservimit* është *ruajtja e domethënies kulturore të një vendi*.
- 2.3 *Konservimi* është pjesë përbërëse e mirëmenaxhimit të *vendeve me domethënie kulturore*.
- 2.4 *Vendet me domethënie kulturore* duhet të mbrohen dhe të mos vendosen në rrezik ose të lihen në një gjendje të brishtë.

### Neni 3. Përqasja e kujdesshme

- 3.1 *Konservimi* bazohet në respektimin e strukturës ekzistuese, përdorimit, asociacioneve (bashkëshoqëimeve) dhe kuptimeve. Ai kërkon një përqasje të kujdesshme për të ndryshuar aq sa është e nevojshme, por sa më pak të jetë e mundur.
- 3.2 Ndryshimet në një vend nuk duhet të shtrembërojnë dëshmitë fizike apo të natyrave të tjera që ai ofron, dhe as nuk duhet të bazohen mbi hamendësime.

Gjurmët e shtesave, ndryshimeve dhe trajti- meve të mëhershme të strukturës së një vendi janë dëshmi të historisë së tij dhe përdorimeve që mund të jenë pjesë e domethënies së tij. Konservimi duhet të ndihmojë dhe të mos pengojë në të kuptuarit e tyre.

### Neni 4. Njohuritë, aftësitë dhe teknikat

- 4.1 *Konservimi* duhet të përdorë të gjitha



njohuritë, aftësitë dhe disiplinat të cilat mund të kontribuojnë në studimin e një vendi dhe kujdesin ndaj tij.

- 4.2 Për *konservimin e strukturave* të rëndësishme preferohen teknikat dhe materialet tradicionale. Në disa rrethana mund të jenë të pershtatshme edhe teknikat dhe materialet moderne, nëse ato ofrojnë përfitime domethënëse për konservimin.

Përdorimi i materialeve dhe teknikave moderne duhet të mbështetet në dëshmi shkencore të qëndrueshme ose në një përvojë të gjerë.

### Neni 5. Vlerat

- 5.1 *Konservimi* i një vendi duhet të identifikojë dhe të marrë në konsideratë të gjitha aspektet e rëndësishme kulturore dhe natyrore, pa i kushtuar vëmendje të pajustificuar një vlere në dëm të tjerave.

Konservimi i vendeve me domethënie natyrore shpjegohet në Kartën e Trashëgimisë Natyrore Australiane. Kjo Kartë e përcakton domethënien natyrore si rëndësia e vlerës së ekzistencës së ekosistemeve, biodiversitetit dhe gjeodiversitetit, ose vlera e tyre për brezat e sotëm apo të ardhshëm, në kuptimin e vlerave shkencore, shoqërore, este- tike dhe të mbështetjes së jetës. Në disa kultura, vlerat natyrore dhe kulturore janë të pandashme.

- 5.2 Shkallët relative të *domethënies kulturore* mund të çojnë në veprime të ndryshme konservuese në një vend.

Kërkohej një përjasje e kujdesshme, pasi kuptimi i domethënies kulturore mund të ndryshojë me kalimin e kohës. Ky nen nuk duhet të përdoret për të justifikuar veprime që nuk ruajnë domethënien kulturore.

### Neni 6. Procesi i Kartës së Burrës

- 6.1 *Domethënia kulturore* e një vendi dhe çështjet e tjera që ndikojnë në të ardhmen e tij kuptohen më mirë nëpërmjet një serie grumbullimi të dhënash dhe analizash para se të merren vendime. Kuptimi i domethënies kulturore vjen i pari, pastaj zhvillimi i politikave dhe në fund menaxhimi (administrimi) i vendit në përputhje me politikat. Ky është Procesi i Kartës së Burrës.

Procesi i Kartës së Burrës, ose rendi i hulumtimeve, vendimeve dhe veprimeve, ilustron më poshtë, dhe në mënyrë më të hollësishme në fund të grafiku i rrjedhës së procesit, që është edhe pjesë përbërëse e Kartës:



- 6.2 Politika për menaxhimin e një *vendi* duhet të bazohet në *kuptimin e domethënies kulturore* të tij.

- 6.3 Zhvillimi i politikave duhet të marrë në konsideratë edhe faktorë të tjerë që prekin të

ardhmen e një *vendi*, si nevojat e pronarëve, burimet, kufizimet e jashtme dhe gjendjen e tij fizike.

6.4 Në zhvillimin e një politike efektive, mund të shqyrtohen mënyra të ndryshme për të ruajtur *domethënien kulturore* dhe për të adresuar faktorët e tjerë ndikues.

Opsionet e shqyrtuara mund të përfshijnë një gamë përdorimesh dhe ndryshimesh (p.sh. përshtatje) të një vendi.

6.5 Ndryshimet e rrethanave, ose informacione apo këndvështrime të reja, mund të krijojnë nevojën për përsëritjen e një pjese ose të të gjithë Procesit të Kartës së Burrës.

## Neni 7. Përdorimi

7.1 Kur *përdorimi* i një *vendi* ka *domethënie kulturore*, atëherë përdorimi duhet vazhduar.

7.2 Një *vend* duhet të ketë një *përdorim të përshtatshëm*.

Politikat duhet të identifikojnë një përdorim ose kombinim përdorimesh, apo kufizime në përdorim, që e ruajnë *domethënien kulturore* të vendit. Përdorimi i ri i një vendi duhet të përfshijë ndryshime minimale të strukturës dhe të përdorimit; duhet të respektojë asociacionet (bashkëshoqërimet) dhe kuptimet; dhe, kur është e përshtatshme, duhet të sigurojë vazhdimësinë e aktiviteteve dhe praktikave që kontribuojnë në *domethënien kulturore* të vendit.

## Neni 8. Mjedisi rrethues

*Konservimi* kërkon ruajtjen e një *mjedisi rrethues* të përshtatshëm. Kjo përfshin ruajtjen e mjedisit rrethues pamor dhe shqisor, si dhe ruajtjen e marrëdhënieve shpirtërore dhe kulturore që kontribuojnë në *domethënien kulturore* të vendit.

Ndërtimet e reja, prishjet, ndërhyrjet apo ndryshimet e tjera të cilat do të ndikonin negativisht në mjedisin rrethues ose asociacionet (bashkëshoqërimet) nuk janë të përshtatshme.

Mjedisi rrethues është shpjeguar në nenin 1.12.

## Neni 9. Vendndodhja

9.1 Vendndodhja fizike e një *vendi* është pjesë e *domethënies* së tij *kulturore*. Një ndërtesë, një vepër ose një tjetër element i një vendi duhet të mbetet në vendndodhjen e tij historike. Zhvendosja është përgjithësisht e papranueshme, përveç rastit kur kjo është mënyra e vetme praktike për të siguruar mbijetesën e një elementi.

- 9.2 Disa ndërtesa, vepra ose elemente të tjera të vendeve janë projektuar për t'u hequr lehtësisht, ose e kanë tashmë një histori zhvendosjesh. Kur ndërtesat, veprat apo elementet e tjera nuk kanë lidhje të rëndësishme me vendndodhjen e tyre aktuale, zhvendosja mund të jetë e pranueshme.
- 9.3 Nëse ndonjë ndërtesë, vepër ose element tjetër zhvendoset, duhet të vendoset në një vend të përshtatshëm dhe t'i jepet një *përdorim* i përshtatshëm. Një veprim i tillë nuk duhet të jetë në dëm të ndonjë vendi me *domethënie kulturore*.

### **Neni 10. Përmbajtja**

Përmbajtjet, instalimet dhe objektet që kontribuojnë në *domethënien kulturore* të një vendi duhet të mbahen në atë vend. Zhvendosja e tyre është e papranueshme, përveç rasteve kur është: mënyra e vetme për të garantuar sigurinë dhe *ruajtjen* e tyre; në baza të përkohshme për trajtim ose ekspozim; për arsye kulturore; për shëndetin dhe sigurinë; ose për të mbrojtur vendin. Këto përmbajtje, instalime apo objekte duhet të kthehen aty ku rrethanat e lejojnë dhe kur është kulturalisht e përshtatshme.

Për shembull, riatdhesimi (kthimi) i një objekti ose elementi në një vend mund të jetë i rëndësishëm për kulturat indigjene dhe mund të jetë thelbësore për ruajtjen e rëndësisë (*domethënies*) së tij kulturore. Neni 28 mbulon rrethanat kur struktura të rëndësishme mund të çekuilibrohen, për shembull, gjatë gërmimeve arkeologjike.

Neni 33 trajton rastet kur struktura të rëndësishme janë zhvendosur nga një vend.

### **Neni 11. Vende dhe objekte të ndërlidhura**

Kontributi që *vendet e ndërlidhura* dhe *objektet e ndërlidhura* i japin *domethënies kulturore* të një vendi duhet të ruhet.

### **Neni 12. Pjesëmarrja**

*Konservimi, interpretimi* dhe menaxhimi i një vendi duhet të sigurojë pjesëmarrjen e njerëzve për të cilët vendi ka asociacione (bashkëshoqërime) dhe kuptime domethënëse, ose që kanë përgjegjësi shoqërore, shpirtërore apo kulturore për vendin.

### **Neni 13. Bashkekzistenca e vlerave kulturore**

Bashkekzistenca e vlerave kulturore duhet të njihet, të respektohet dhe të inkurajohet gjithmonë. Kjo është veçanërisht e rëndësishme në rastet kur ato janë në konflikt me njera-tjetrën.

Për disa vende, vlerat kulturore kontradiktore mund të ndikojë në zhvillimin e politikave dhe vendimet menaxheriale. Në Nenin 13, termi vlerat kulturore i referohet atyre besimeve të cilat janë të rëndësishme për një grup kulturor, duke përfshirë besimet politike, fetare, shpirtërore dhe morale, por pa u kufizuar në to. Kjo është më e gjerë se vlerat e lidhura me *domethënien kulturore*.

## PROCESET E KONSERVIMIT

### Neni 14. Proceset e konservimit

*Konservimi*, sipas rrethanave, mund të përfshijë proceset në vijim: vazhdimin ose rikthimin e një *përdorimi*; ruajtjen e asociacioneve (*bashkëshoqërimeve*) dhe *kuptimeve*; *mirëmbajtjen*, *ruajtjen*, *restaurimin*, *rindërtimin*, *përshtatjen* dhe *interpretimin*; dhe zakonisht përfshin një kombinim të më shumë se njëres prej tyre. Konservimi gjithashtu mund të përfshijë ruajtjen e kontributit që japin *vendet e ndërlidhura* dhe *objektet e ndërlidhura në domethënien kulturore të një vendi*.

Konservimi zakonisht kërkon të ngadalësojë përqendrimin e një vendi, përveç rasteve kur domethënia e vendit dikton ndryshe. Mund të ketë rrethana kur nuk kërkohet asnjë veprim për të realizuar konservimin.

### Neni 15. Ndryshimi

15.1 Ndryshimi mund të jetë i nevojshëm për të ruajtur *domethënien kulturore*, por është i padëshirueshëm kur e redukton domethënien kulturore. Masa e ndryshimit të një *vendi* dhe *përdorimit* të tij duhet të udhëhiqet nga *domethënia kulturore* dhe *interpretimi* i duhur i tij.

Kur merret në konsideratë një ndryshim, qoftë edhe për një përdorim të përkohshëm, duhen vlerësuar disa variante për të përzgjedhur atë që minimizon më shumë reduktimin e domethënies kulturore. Mund të jetë i përshtatshëm ndryshimi i një vendi kur ky reflekton një ndryshim të kuptimeve dhe praktikave kulturore të tij, por gjithmonë duhet respektuar domethënien e vendit.

15.2 Ndryshimet që reduktojnë *domethënien kulturore* duhet të jenë të rikthyeshme, dhe kthimi duhet bërë kur rrethanat e lejojnë.

Ndryshimet e rikthyeshme duhet të konsiderohen si të përkohshme. Ndryshimet jo të rikthyeshme duhet të përdoren vetëm si mjeti i fundit, dhe nuk duhet të bëhen pengesë për veprimet e ardhshme konservuese.

15.3 Në përgjithësi, çdo dëmtim i strukturës së një vendi nuk është i pranueshëm. Megjithatë, në disa raste prishje të vogla mund të jenë të pranueshme si pjesë e konservimit. Kur rrethanat e lejojnë, strukturat e zhvendosura duhet të rikthehen.

15.4 Kontributet e të gjitha aspekteve të *domethënies kulturore* të një *vendi* duhen respektuar. Nëse një vend përfshin *struktura*, *përdorime*, asociacione (*bashkëshoqërime*) ose *kuptime* nga periudha të ndryshme, apo aspekte të ndryshme të domethënies kulturore, theksimi ose interpretimi i një periudhe ose aspekti në dëm të të tjerëve mund të justifikohet vetëm kur ajo që është përjashtuar, hequr ose pakësuar ka një domethënie të vogël kulturore, ndërsa ajo që theksohet ose interpretohet ka domethënie shumë më të madhe kulturore.

### **Neni 16. Mirëmbajtja**

Mirëmbajtja është thelbësore për konservimin. Mirëmbajtja duhet të ndërmerret aty ku struktura ka domethënie kulturore dhe mirëmbajtja është e nevojshme për ruajtjen e saj.

Mirëmbajtja e një vendi mund të jetë er ëndësishme për respektimin e ligjeve dhe traditave zakonore në disa komunitete indigjene ose grupe të tjera kulturore.

### **Neni 17. Ruajtja**

*Ruajtja* është e nevojshme kur struktura ekzistuese ose gjendja e saj përbën dëshmi lidhur me domethënien (rëndësinë) kulturore, ose kur mungojnë të dhëna të mjaftueshme për të mundësuar procese të tjera *konservuese*.

Ruajtja e mbron strukturën pa fshehur dëshmitë për ndërtimin dhe përdorimin e saj. Procesi duhet zbatuar përherë:

- aty ku dëshmia e strukturës është aq e rëndësishme sa që ajo nuk duhet të ndryshohet; ose
- aty ku nuk ka patur hulumtim të mjaftueshëm për të lejuar marrjen e vendimeve politike në përputhje me Nenet 26 - 28.

Punime shtesë (p.sh. stabilizimi) mund të kryhen paralelisht me ruajtjen, kur qëllimet e tyre janë mbrojtja fizike e strukturës dhe kur ato punime janë në përputhje me Nenin 22.

### **Neni 18. Restaurimi dhe rindërtimi**

*Restaurimi* dhe *rindërtimi* duhet të nxjerrin në pah aspekte kulturore domethënëse të një *vendi*.

### **Neni 19. Restaurimi**

*Restaurimi* është i pranueshëm vetëm nëse ka prova të mjaftueshme mbi një gjendje të mëparshme të *strukturës*.

### **Neni 20. Rindërtimi**

20.1 *Rindërtimi* është i pranueshëm vetëm kur një vend është bërë i paplotë përmes dëmtimit ose ndryshimit të tij, dhe vetëm aty ku ka dëshmi të mjaftueshme për të riprodhuar një gjendje të mëparshme të *strukturës*. Në disa raste, rindërtimi mund të jetë gjithashtu i pranueshëm si pjesë e një përdorimi ose praktike që ruan *domethënien kulturore* të vendit.

Vendet me vlerë shoqërore ose shpirtërore mund të kërkojnë rindërtim, edhe pse mund të ketë shumë pak mbetje prej tyre (p.sh. vetëm bazamentet e ndërtesave ose cungjet e pemëve të mbetura pas zjarrit, përmbytjes apo stuhisë). Kërkesa për të gjetur prova të mjaftueshme për të riprodhuar një gjendje të mëparshme duhet zbatuar edhe këtu.

20.2 *Rindërtimi* duhet të jetë i identifikueshëm përmes inspektimit nga afër ose nëpërmjet *interpretimit* shtesë.

## Neni 21. Përshtatja

21.1 *Përshtatja* është e pranueshme vetëm kur ajo ka ndikim të papërfillshëm në *domethënien kulturore të vendit*.

21.2 *Përshtatja* do duhej të shkaktonte vetëm ndryshime shumë të vogla në një strukturë domethënëse, dhe kjo gjë arrihet vetëm pas shqyrtimit të disa alternativave.

## Neni 22. Vepër e re

22.1 Veprat e reja, si shtesat ose ndryshimet e tjera të një *vendi*, mund të të jenë të pranueshme kur ato e respektojnë *domethënien kulturore të vendit*, dhe kur nuk e shtrembërojnë apo zbehin atë, si dhe kur nuk e varfërojnë interpretimin dhe vlerësimin e tij.

22.2 Vepra e re duhet të jetë lehtësisht e identifikueshme si e tillë, por duhet të respektojë *domethënien kulturore të vendit* dhe të ketë ndikim sa më të kufizuar në të.

## Neni 23. Vazhdimi ose rikthimi i përdorimit

Vazhdimi, modifikimi ose rifutja e një përdorimi të rëndësishëm mund të jenë forma të përshtatshme dhe të preferuara të konservimit.

Përshtatja mund të përfshijë shtesa në një vend, shërbime të reja, ose një përdorim të ri, apo ndryshime për të mbrojtur vendin. Përshtatja e një vendi për një përdorim të ri shpesh konsiderohet si 'ripërdorim i përshtatur' dhe duhet të jetë në përputhje me nenin 7.2.

Këto mund të kërkojnë ndryshime në strukturën e rëndësishme, por duke i mbajtur ato në minimumin e mundshëm. Në disa raste, vazhdimi i një përdorimi, aktiviteti ose praktike të rëndësishme mund të kërkojë ndërhyrje të reja në përmasa të mëdha.

## Neni 24. Vazhdimi i asociacioneve (bashkëshoqërimeve) dhe i kuptimeve

24.1 *Asociacionet (bashkëshoqërimet)* domethënëse ndërmjet njerëzve dhe një *vendi* duhet të respektohen, vazhdohen dhe të mos veniten. Duhet të hulumtohen dhe zbatohen mënyra për të përfutuar nga çdo mundësi për *interpretimin*, përkujtimin dhe kremtimin e këtyre asociacioneve (bashkëshoqërimeve).

Për shumë vende asociacionet (bashkëshoqërimet) lidhen me aspekte të përdorimit, duke përfshirë aktivitete dhe praktika.

Disa bashkëshoqërime dhe kuptime mund të mos jenë të dukshme dhe kanë nevojë për hulumtime të thelluara.

24.2 Kuptimet domethënëse duhet të respektohen, duke përfshirë vlerat shpirtërore të një vendi. Duhet kërkuar mundësi për vazhdimin dhe rigjallërimin e këtyre kuptimeve.

## Neni 25. Interpretimi

*Domethënia kulturore* e shumë vendeve nuk është lehtësisht e dukshme dhe duhet të shpjegohet me anë të *interpretimit*. Interpretimi duhet të përmirësojë kuptimin dhe angazhimin, si dhe të jetë i përshtatshëm kulturalisht.

Në disa rrethana çdo formë interpretimi mund të jetë kulturalisht e papërshtatshme.

## PRAKTIKA E KONSERVIMIT

### Neni 26. Zbatimi i procesit të Kartës së Burrës

26.1 Punimet në një vend duhet të paraprihen nga studime për të kuptuar vendin, të cilat duhet të përfshijnë analiza të dëshmive fizike, dokumentare, gojore dhe dëshmi të tjera, duke u mbështetur në njohuri, aftësi dhe disiplina të përshtatshme.

Rezultatet e studimeve duhet të mbahen të përditësuara, duke i rishikuar dhe ndryshuar rregullisht sipas nevojës.

26.2 Deklarata të shkruara për *rëndësinë kulturore* dhe politikat për një *vend* duhen përgatitur, arsyetuar dhe duhen shoqëruar me dëshmi mbështetëse. Deklaratat për domethënien dhe politikat duhet të përfshihen në një plan menaxhimi për vendin.

Politika duhet të adresojë të gjitha çështjet e rëndësishme, p.sh. përdorimin, interpretimin, menaxhimin dhe ndryshimin. Një plan menaxhimi është një dokument i do-bishëm për regjistrimin e procesit të Kartës së Burrës, d.m.th. hapat në planifikimin dhe menaxhimin e një vendi me domethënie kulturore (Neni 6.1 dhe grafiku i rrjedhës së procesit). Plane të tilla shpesh quhen planet e menaxhimit të konservimit, por ndonjëherë kanë edhe emra të tjerë. Plani i menaxhimit mund të merret edhe me çështje të tjera që lidhen me menaxhimin e vendit.

26.3 Grupeve dhe personave që kanë lidhje me një vend, sikurse edhe ata që janë të përfshirë në menaxhimin e tij, duhet t'u krijohet mundësia për të dhënë kontributin e tyre dhe për të marrë pjesë në identifikimin dhe të kuptuarit e *domethënies (rëndësisë) kulturore* të vendit. Aty ku është e pranueshme, atyre duhet t'u jepet gjithashtu mundësia për të marrë pjesë në *konservimin* dhe menaxhimin e vendit.

26.4 Deklaratat për *domethënien (rëndësinë) kulturore* dhe politikat për një *vend* duhet të rishikohen periodikisht, si dhe veprimet dhe pasojat e tyre duhet të monitorohen për të siguruar përshtatshmëri dhe efektivitet të vazhdueshëm.

Monitorimi i veprimeve kryhet edhe për verifikimin e pasojave të padëshiruara.

## **Neni 27. Menaxhimi i ndryshimit**

27.1 Ndikimi i ndryshimeve të propozuara mbi *domethënien kulturore* të një *vendi*, përfshirë ndryshimet me rritje graduale, duhet vlerësuar mbi bazën e deklaratës së domethënies (rëndësisë) dhe politikave për menaxhimin e vendit. Mund të jetë i nevojshëm modifikimi i ndryshimeve të propozuara për të ruajtur më mirë domethënien (rëndësinë) kulturore.

27.2 *Struktura, përdorimi, asociacionet (bashkëshoqërimet)* dhe *kuptimet* ekzistuese duhet të dokumentohen saktësisht përpara dhe pas çdo ndryshimi që i bëhet *vendit*.

## **Neni 28. Dëmtimi i strukturës**

28.1 Dëmtimi i *strukturës* domethënëse për arsye studimore, apo për marrjen e të dhënave, duhet të jetë minimal. Studimi i një *vendi* nëpërmjet ndonjë dëmtimi të strukturës, duke përfshirë gërmimet arkeologjike, duhet të ndërmerret vetëm për të përftuar të dhëna thelbësore për vendimet mbi *konservimin* e vendit, ose për të marrë të dhëna të rëndësishme që janë pranë zhdukjes ose që janë duke u bërë të paqasshme.

28.2 Hulumtimi që kërkon dëmtim të strukturës së një vendi, përveç asaj çka është e nevojshme për të marrë vendime, mund të jetë i përshtatshëm me kushtin që të jetë në përputhje me politikën për vendin. Një hulumtim i tillë duhet ngritur mbi çështje të rëndësishme kërkimore të cilat kanë potencialin për t'i pasuruar njohuritë në lidhje me vendin, dhe të cilat nuk mund të marrin përgjigje ndryshe. Ato duhet gjithashtu të minimizojnë dëmtimin e strukturës domethënëse.

## **Neni 29. Përgjegjësia**

Organizatave dhe personat përgjegjës për menaxhimin dhe vendimet duhet të njihen me emër dhe të mbajnë përgjegjësi specifike për çdo vendim.

## **Neni 30. Drejtimi, mbikëqyrja dhe zbatimi**

Duhet patur një drejtim dhe mbikëqyrje kompetente në çdo fazë, dhe çdo ndryshim duhet të bëhet nga njerëz me njohuritë dhe aftësitë e duhura.



### **Neni 31. Mbajtja e regjistrit**

Prova/dëshmi të reja mund të dalin në dritë gjatë zbatimit të politikave ose planeve në një vend. Mund të zhvillohen faktorë të tjerë që kërkojnë vendime të reja. Duhet mbajtur një regjistër për dëshmitë e reja dhe vendimet shtesë.

Vendimet e reja duhet të respektojnë domethënien kulturore të vendit dhe të kenë ndikim minimal në të.

### **Neni 32. Të dhënat**

32.1 Të dhënat që lidhen me konservimin e një *vendi* duhet të depozitohen në një arkiv të përhershëm dhe të jenë të hapura për publikun, në varësi të kërkesave të sigurisë dhe privatësisë, dhe aty ku kjo gjë është kulturalisht e përshtatshme.

32.2 Të dhënat për historinë e një vendi duhet të mbrohen dhe duhen vënë në dispozicion të publikut, në varësi të kërkesave të sigurisë dhe privatësisë, dhe aty ku kjo gjë është kulturalisht e përshtatshme.

### **Neni 33. Struktura e zhvendosur**

*Struktura* domethënëse e zhvendosur nga një vend, përfshirë përmbajtjet, instalimet dhe objektet, duhet të katalogohet dhe mbrohet në përputhje me *domethënien* e saj *kulturore*.

Aty ku është e mundur dhe e përshtatshme kulturalisht, struktura domethënëse e zhvendosur duhet të mbahen në vend, duke përfshirë përmbajtjen, instalimet dhe objektet.

### **Neni 34. Burimet**

Duhet të sigurohen burime të përshtatshme për *konservim*.

Konservimi më i mirë shpesh përfshin më pak punë dhe mund të jetë jo i shtrenjtë. Fjalët me gërma të pjerrëta janë përkufizuar në Nenin 1.

# PROCESI I KARTËS SË BURRËS

Hapat për planifikimin dhe menaxhimin (administrimin) e vendeve me rëndësi (domethënie) kulturore

Karta e Burrës duhet lexuar në tërësinë e saj.

Nene kyç për secilin hap janë vendosur në kutitë më poshtë. Neni 6 përmbledh Procesin e Kartës së Burrës.

